REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 949/20
Datë/Datum. 16.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: MIN.E BUJQËSISË,PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 203-20-3525-2-1-1

Sa i përket tenderit për "Shërbimet të kontrollit dhe zhvillimit të kulturave bujqësore përmes imazheve satelitore"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"Mescioglu Muhendislik ve Musavirlik A.S & Urban Metropol sh.p.k".
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

"Shaban Polluzha" P.n.
(Adresa)
Prishtinë — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*
045/424-499
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Ayhan Faruk Mesci
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
mescioglu.ofis@gmail.com
(Adresa elektronike)

12.11.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

MESCIOGLU MUHENDISLIK VE MUSAVIRLIK ANONIM SIRKETI
Dega në Kosovë
Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi paraprak: 10.07.2020
Njoftimi per kontrate: 20.07.2020
Afati i dorzimit te tendereve: 25.09.2020
Hapja e tenderit: 25.09.2020
Procesverbali i hapjes: 25.09.2020
Njoftimi mbi vendimin e AK-se: 28.10.2020
Kerkesa per rishqyrtim: 02.11.2020
Vendimi nga AK: 09.11.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

AK së pari ka bërë shkeljen e nenit 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, në bazë të të cilit AK duhet t'i kërkojë OE-së informata shtesë rreth dokumentacionit të dërguar, gjë që se ka bërë.

Së dyti ne i kemi ngarkuar dokumentacionet për të cilat AK pretendon që ne jemi të papërgjegjshëm. Përkundër kësaj ne si OE jemi shpallur të pasukseshëm edhe pse i kemi pasur të gjitha dokumentet e ngarkuara dhe kemi qenë plotësisht të përgjegjshëm sa i përket kërkesave që kanë qenë në DT.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues – M.Bujqësisë, Pylltarisë dhe zhv.Rural gjatë procesit të zhvillimit dhe anulimi të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me LPP-në, përkatësisht shkeljen e dispozitave të LPP-së:

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës
Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kërkesat të cilat nuk janë përmbushur janë:

- III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:
  - Kërkesa 2 - Të dy kompanitë nuk kanë sjellë Vërtetimin nga Gjykata Themelore
  - Kërkesa 3 - Të dy kompanitë nuk kanë sjellë Vërtetimin nga ATK
- III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
  - Kërkesa 2 – Njërit ekspert i mungon Certifikata për analiza të imazheve satelitore
  - Kërkesa 3 – Ekspertit i mungon certifikata nga prodhuesi i dronit
  - Kërkesa 5 – Njërit ekspert i mungon diploma Master
  - Kërkesa 8 – Mungon Kontrata me prodhuesin e imazheve satelitore
  - Kërkesa 9 – Mungon DUD-i doganor i Dronit

Ju rikujtojmë që për pikën III.2.1 kërkesa në DT ka qenë:

- **Dëshmi se kompania nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore lëshuar nga Gjykata Themelore- kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar jo më e vjetër 30 ditë, (mos dorëzimi i kësaj dëshmie nuk do të diskualifikoj tenderin tuaj, por duhet dorë nga OE te cilit synohet dhënia e kontratës).**
- **Një vërtetim i lëshuar nga AdministrataTatimore i vendit tuaj të themelimit se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit, (mos dorëzimi i kësaj dëshmie nuk do të diskualifikoj tenderin tuaj, por duhet dorëzohet nga OE te cilit synohet dhënia e kontratës).**

Dhe si e tillë është shkelje nga ana e AK-së që të diskualifikohemi për këtë arsye, kur të dy vërtetimet janë të obliguar të dorëzohen për OE-në të cilës i synohet dhënja e kontratës.

III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional:

- **Kërkesa 2. Njërit ekspert i mungon certifikata për analiza të imazheve satelitore;**

Ne i kemi ofruar tre ekspertët të cilët janë kërkuar në DT dhe ata janë:
1.Mustafa Onder i cili i ka përmbushur të gjitha kërkesat e kërkuara, certifikata e të cilit ka qenë e ngarkuar në pikën *18.Certifikatat* (ju lutem t'i kontrolloni).
2.Ongun Sumnulu e cila i ka përmbushur të gjitha kërkesat e kërkuara, certifikata e të cilës ka qenë e ngarkuar në pikën *18.Certifikatat* (ju lutem t'i kontrolloni), gjithashtu edhe diplomën master e ka në këtë drejtim.
3.Nilhan Çiftçi e cila i ka përmbushur të gjitha kërkesat e kërkuara, certifikata e të cilës ka qenë e ngarkuar në pikën *16.Tre ekspert te analizave të imazheve satelitore* (ju lutem t'i kontrolloni) gjithashtu edhe diplomën master e ka në këtë drejtim.

Ne i kemi përmbushur kërkesat sipas DT ju lutem ti kontrolloni më detajisht edhe njëherë pikat e treguara (ka mundësi prej dosjes voluminoze të iu kenë ngatërruar).

- **Kërkesa 3. Ekspertit i mungon certifikata nga prodhuesi i dronit;**

Eksperti Abdullah Yusuf Ekinci i ka përmbushur të gjitha kërkesat e kërkuara në DT, si dhe certifikatën e ka nga prodhuesi i dronit dhe ka qenë e ngarkuar në pikën *11.Inxhinier për matje me Dron* (ju lutem e kontrolloni më detajisht).

- **Kërkesa 5. Njërit ekspert i mungon diploma master;**

Në DT janë kërkuar dy ekspert të bujqësisë, ne i kemi ofruar tre të tillë:
1.Yakup Alpaslan Ergun diploma master e të cilit është e ngarkuar në pikën *20.Expertet e bujqesise* (fq.5);
2.Tevfik Turk diploma master e të cilit është e ngarkuar në pikën *20.Expertet e bujqesise* (fq.16);
3.Ali Kaplan diploma master e të cilit është e ngarkuar në pikën *20.Expertet e bujqesise* (fq.27);

Të gjithë i kanë përmbushur kërkesat e parashtruara në DT, të gjithë janë inxhiniera – poashtu të gjithë i kanë diplomat master, asnjë nuk është bachelor (mjafton që e kan vetem diplomen se jane inxhinjera) - ju lutem i kontrolloni më detajisht.

- **Kërkesa 8. Mungon Kontrata me prodhuesin e imazheve satelitore;**

Në pikën 9.Kontrata për imazhe satelitore, janë ngarkuar dy kontrata/marrëveshje me prodhuesit e imazheve satelitore, kontrata këto të cilat janë të specifikuara për tenderin në fjalë (Ju lutem i kontrolloni).

- **Kërkesa 9. Mungon DUD-i doganor i Dronit;**

Në kërkesën e DT ka qenë ***Dëshmi 9 OE duhet te dëshmojë posedimin e Dronit me fature dhe dëshmitë e pagesës, DUD doganor.***

Ne i kemi ofruar dy Dronë, njëri është blerë nga prodhues Turk dhe si i tillë nuk ka DUD doganor dhe tjetri është blerë në Gjermani dhe dudi ka qenë i bashkangjitur në pikën *10. Dron profesional (*fq.6)

*AK së pari ka bërë shkeljen e **nenit 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë**, në bazë të të cilit AK duhet t'i kërkojë OE-së informata shtesë rreth dokumentacionit të dërguar, gjë që se ka bërë.*

*Së dyti AK-ja ka bërë shkeljen e **neneve të cekura në pikën 7 të ankesës**, sepse ne i kemi ngarkuar dokumentacionet për të cilat AK pretendon që ne jemi të papërgjegjshëm. Përkundër kësaj ne si OE jemi shpallur të pasukseshëm edhe pse i kemi pasur të gjitha dokumentet e ngarkuara dhe kemi qenë plotësisht të përgjegjshëm sa i përket kërkesave që kanë qenë në DT.*

Ju lutem keni parasysh ankesën tonë dhe i kontrolloni më detajisht pretendimet e që ne kemi mungesë në dokumentacion. Ne si OE veçse kemi ngarkuar dokumente shtesë, kemi ofruar një dosje voluminoze, prandaj ju lutem i kontrolloni.

Kërkojmë nga ju që ankesën tonë ta merrni si të bazuar dhe të na shpallin si OE të përgjegjshëm, sepse i kemi përmbushur të gjitha kërkesat sipas dosjes së tenderit si dhe jemi OE-ja me çmimin më të ulët të ofruar.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet dhe shpenzimet e shkaktuara me rastin e përgaditjes së ofertës, shpenzimet e sigurimit të tenderit, fitimet e pritura gjatë realizimit të kontratës, shpenzimet e pregaditjes së kërkesës për rishqyrtim pranë AK-së si dhe shpenzimet e pregaditjes së ankesës pranë OSHP-së.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*